

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

*Tema: **KRAHASIMI I KOHËS SË LIRË TË NXËNËSVE NË ZONAT URBANE DHE RURALE TË SHKOLLAVE FILLORE TË KOMUNËS SË DRENASIT***

(COMPARSION OF PRIMARY SCHOOLS STUDENT’S FREE TIME IN DRENAS MUNICIPALITY RURAL AND URBAN AREAS)

MENTORI:
Dr. Sc. Shqipe Bajqinca

KANDIDATI:
BSc.Ylber Qorri & Prof.Agron Dubovci

Prishtinë, Shkurt, 2019

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. PROBLEMI, LËNDA, DHE QËLLIMI	5
3. HIPOTEZAT THEMELORE	6
4. METODAT E PUNËS	7
4.1 Rrjedha dhe procedura e hulumtimit.....	7
4.2 Mostra e të testuarve	8
4.3 Instrumentet matëse të mostrës	8
4.4 Përpunimi statistikor i të dhënave.....	12
5. REZULTATET E HULUMTIMIT	13
6. RËNDEsia E HULUMTIMIT.....	32
7. DISKUTIMI	33
8. PËRFUNDIMI.....	37
Conclusion	43
Literatura.....	48

1. HYRJJE

Kushtet bashkëkohore të jetës dhe të punës mund të konsiderohen të ndryshme nga ato disa dekadave më parë. Zhvillimi i teknologjisë, shkencave kompjuterike, transportit dhe komunikimit, jeta dinamike ka përshpejtuar jetën tonë të përditshme. Gjithashtu, bota në të cilën fëmijët tonë po rriten ka ndryshuar. Rrjedhimisht, ritmi i rritur i jetesës i cili karakterizon jetën bashkëkohore u ka siguruar njerëzve më shumë kohë të lirë, që është megjithatë më pak e përdorur për nevoja personale (Andrijašević M. , Slobodno vrijeme i igra, 2000).

Koha e lirë është një nga përcaktuesit e zhvillimit njerëzor, një mundësi për liri njerëzore dhe zhvillim personal. Kjo është një parakusht themelor për një numër aktivitete që forcojnë trupin dhe mendjen dhe gjithashtu përmirësojnë shëndetin (Basić, 1993). Sot, raporti i kohës së lirë dhe punës në shkollë po ndryshon gjithnjë e më shumë për fëmijët dhe të rinjtë. Fëmijët janë të mbingarkuar me detyrime të shumta akademike dhe për këtë arsye është edhe më e rëndësishme t'u ofrohen atyre aktivitete të ndryshme fizike në pjesën tjetër të ditës. Koha e lirë duhet të jetë një kohë për pushim aktiv, kohë të lirë, pozitive ka zhvillimin, socializimin, miqësinë dhe zhvillimin e personalitetit. Kohën e lirë, përmbajtja dhe aktivitetet fizike po bëhen përcaktues mjaft të rëndësishëm në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve. Secili fëmijë duhet të jetë në gjendje të zgjedh atë që ai ose ajo është e interesuar, por shpesh është e nevojshme t'u jepet atyre një propozim dhe t'i prezantojmë aktivitete të ndryshme para tyre. Në kohën e lirë të fëmijës, rëndësi të madhe duhet t'i kushtohet aktiviteteve fizike, nevojës themelore njerëzore për lëvizje. Dy orë në javë të edukimit fizik në arsimin fillor nuk janë të mjaftueshme, prandaj mësimmësuesit duhet të rekomandojnë dhe këshillojnë nxënësit e tyre që sa më tepër të merren me aktivitete të lira fizike në kohën e tyre të lirë. Në një luftë të përditshme kundër stilit të jetesës pasive dhe të ulur, të rinjtë duhet të inkurajohen vazhdimisht për të ecur sa më tepër në këmbë, vrapojnë, vozisin biçikletën, të angazhohen në lojëra sportive dhe një shumëllojshmëri të aktiviteteve të tjera sportive dhe rekreative, veçanërisht ato në të cilat gjymtyrët, zemra dhe mushkëritë janë të përfshirë në mënyrë aktive (Andrijašević

M. , 2000). Ndikimi i shoqërisë, prindërve, mësuesve dhe veçanërisht mësuesve të Edukatës Fizike ka një ndikim të madh në përzgjedhjen e aktiviteteve të ndryshme fizike nga ana e fëmijëve në shpenzimin e kohës së tyre të lirë. (Badrić, Prskalo, & Kvesić, 2011) tregojnë rëndësinë e aktiviteteve fizike në kohën e lirë të fëmijëve dhe theksojnë nevojën për të krijuar programe ndërhyrëse me qëllim të rritjes së numrit të ushtrimeve fizike të fëmijëve, d.m.th. që aplikimi i aktiviteteve fizike të bëhet zakon i përditshëm. Sipas autorëve (Glapa, Bronikowski, Górka, & Morina, 2013), niveli i pasurisë (jo shumë i familjes, por i të gjithë vendit) mund të ketë ndikim në zgjedhjen e aktiviteteve të ndërmarra nga të rinjtë.

Me qëllim të qartësisë, së pari termi i kohës së lirë kërkon sqarime. Për herë të parë u përcaktua gjatë një konference ndërkombëtare të mbajtur në vitin 1956. Siç përcaktohet nga sociologu francez (Dumazedier J, 1956), koha e lirë nënkupton të gjitha aktivitetet e marra nga një individ për argëtim ose vetë-zhvillim, pjesëmarrje vullnetare në jetën shoqërore jashtë sociale dhe përgjegjësitë familjare. Nga ana tjetër, sipas (Dąbrowski, 1966), koha e lirë e të rinjve është koha, e cila mbetet në dispozicion të tyre pas përbushjes së nevojave të trupit të tyre dhe kryerjes së detyrave në shtëpi dhe në shkollë, në të cilën ata mund të kryejnë aktivitetet e tyre në përputhje me shijet e tyre, të lidhura me kohën e lirë, argëtimin dhe përbushjen e interesave të tyre. Për të pasur një pasqyrë më të mirë të stilit të jetesës së të rinjve, studimi kërkimor do të kryhet në dy zona, zonat rurale dhe zonat urbane në Komunën e Drenasit.

2. PROBLEMI, LËNDA, DHE QËLLIMI

Problemi - i hulumtimit është të hetojmë situatën e gjendjes së aktiviteteve të lira të nxënësve në shkollat fillore, në zonat urbane dhe rurale në Komunën e Drenasit.

Lënda -lënda e hulumtimit janë nxënësit e ciklit të tretë të shkollës fillore (klasat 6,7,8,9) femra dhe meshkuj në zonat urbane dhe rurale.

Në përputhje me objektin dhe problemin e definuar të këtij hulumtimi është përcaktuar edhe qëllimi kryesor i hulumtimit.

Qëllimi kryesor -qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është për të përcaktuar se çfarë bëjnë fëmijët gjatë kohës së tyre të lirë, si dhe të shikojmë dallimet në mes të fëmijëve në zonat urbane dhe rurale.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëndës, problemit të hulumtimit dhe qëllimit të hulumtimit, por edhe në përvojën e hulumtimeve të mëparshme, janë formuluar hipotezat e mëposhtme:

H₀: Nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm statistikor të aktiviteteve të lira të fëmijëve në zonat urbane dhe rurale.

A: Ka një dallim të rëndësishëm statistikor të aktiviteteve të lira të fëmijëve në zonat urbane dhe rurale.

4. METODAT E PUNËS

Të dhënat janë mbledhur përmes një pyetëso. Një mjet hulumtues i përdorur për të vlerësuar mënyrën e jetesës së nxënësve, pyetësor i quajtur "Stili im i jetesës", i hartuar nga një ekip hulumtuesish evropianë [Telama R., Naul R., Nupponen H., Rychtecky A., Vuolle P., 2002]. Pyetësoi është përkthyer dhe përshtatur nga një ekip profesional përkthyesish në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, Prishtinë. Hulumtimi do të kryhet në grupin prej 200 fëmijëve në shkollat fillore, nga të cilët 100 nxënës do të jenë nga zonat urbane, ndërsa 100 nxënës do të jenë nga zona rurale. Materiali hulumtues do të mblidhet gjatë muajit qershor të vitit 2018.

4.1 Rrjedha dhe procedura e hulumtimit

Mostra e studimit do të merret nga nxënësit e ciklit të tretë (Kërrikulli e Kosovës) të shkollës fillore, femra dhe meshkuj nga zonat urbane dhe rurale nga Komuna e Drenasit.

Drejtimin dhe procedura, studimi do të përbëhet nga disa faza që përfshin:

- ✓ Projektimin,
- ✓ Identifikimi i mostrës për testim,
- ✓ Realizimi i testimit dhe mbledhjes së të dhënave,
- ✓ Futja e rezultatit në kompjuter,
- ✓ Përpunimi i rezultateve,
- ✓ Interpretimi i rezultateve,
- ✓ Si dhe mbrojtja e temës.

Testimi do të bëhet gjatë kohës sa nxënësit do të jenë në shkollë, pra gjatë procesit mësimor.

Për vlerësimin se çfarë bëjnë nxënësit në kohën e tyre të lirë kemi përzgjedhur një pyetësor standard i quajtur "Stili im i jetesës", pyetësor i cili është përdorur nga shumica e vendeve evropiane, i cili është i vlefshëm dhe unik.

Të gjitha testet do të bëhen në kushte të njëjta ose të ngjashme për çdo grup moshe të testuar.

Testuesit do të jenë mësues të edukimit fizik të cilët janë të arsimuar dhe trajnuar se si të plotësohet testi.

4.2 Mostra e të testuarve

Ky hulumtim do të kryhet me mostra të marra në shkolla fillore të nxënësve femra dhe meshkuj nga zonat urbane dhe rurale. Numri i përgjithshëm do të jetë 200 nxënës të anketuar, 100 nxënës nga zonat urbane dhe 100 nxënës nga zonat rurale.

Mostra do të përfshijë nxënës nga shkolla të ndryshme që përfshinë Komunën e Drenasit, përzgjedhja e nxënësve do të bëhet mbi bazën e një kampioni të thjeshtë të rastit, ku ata do të testohen në mënyrë vullnetare.

4.3 Instrumentet matëse të mostrës

Për vlerësimin e gjendjes se çfarë bëjnë nxënësit me tepër në kohën e tyre të lirë do të përdorim një pyetësor të quajtur " Stili im i jetesës" i cili në vete përmban tetë pyetje:

“STILI IM I JETESËS”

1. Si e kaloni kohën tuaj të lirë? (Ju mund të zgjidhni tri përgjigjeje)

- a) Dëgjoj muzikë,
- b) Luaj muzikë në instrumente, këndoj në korë, në grup,
- c) Shikoj TV, video,
- d) Takoj shokët,
- e) Luaj letra ose lojëra bordit,
- f) Luaj lojëra të kompjuterit,
- g) Lexoj libra, gazeta,
- h) Praktikoj sport në klub, në një seksion të sportit,
- i) Praktikoj sport me miqtë në fushën e sportit,
- j) Shkoj në gara si spektator,
- k) Shkoj në disko,
- l) Shkoj në kinema, teatër, koncert,
- m) hobi (p.sh.: fotografia, modelimi, mbledhja e sendeve etj.).
- n) Çfarë lloj hobe keni? _____
- o) Vizita në familje (gjyshen, gjyshin, axhën, hallën),
- p) Nuk bëjë asgjë (shtrihem në shtrat, ëndërroj, fle gjatë ditës),
- q) Luaj me shokë,
- r) Nëse aktivitete të ndryshme ju lutem shënoni çfarë lloji?

2. Sa herë gjatë tre muajve të fundit, keni ndërmarrë aktivitete fizik në kohën tuaj të lirë (se paku 30 minuta)

- a) Asnjëherë,
- b) Me pak se një herë në javë,
- c) Një herë në javë,
- d) Dy herë në javë,
- e) Tre herë në javë,
- f) Pesë herë në javë,
- g) Çdo ditë.

3. Cilat forma të aktivitetit fizik ju i ndërmerrni gjatë kohës suaj të lirë?

Nr.	Forma	Nganjëherë	Asnjëherë	Shpesh
A.	Vrapimi			
B.	Noti			
C.	Vozis biçikletën			
D.	Roller-skating (patinazh)			
E.	Basketboll			
F.	Volejbol			
G.	Futboll			
H.	Hendboll			
I.	Aerobik			
J.	Ngritje peshe (body building)			
K.	Skate boarding			
L.	Patinazh			
M.	Skijim			
N.	Snowboard			
O.	Gjumnastikë			
P.	Artet marciale (Aikido, karate)			
Q.	Të tjera			

4. **Unë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme fizike, sepse:** (shënoni maksimum tre arsye)

- a) Për karrierë sportive,
- b) Të takoj njerëz të rinjë,
- c) Më pëlqejnë garat,
- d) Për gjendje të mirë fizike,
- e) Për relaksim,
- f) Për shëndet,
- g) Të duket mirë/bukur,
- h) Për nota me të mira në EF,
- i) Për të takuar miq,
- j) Për argëtim,
- k) Unë mund ti përmbush ambiciet e mia sportive,
- l) Familja më inkurajon,
- m) Për përfitime financiare.

5. **Unë ndërmarr aktivitet fizik në kohën lirë me...**

- a) Me prindër,
- b) Me motra dhe vëllezër,
- c) Me shokë,
- d) Vetë,
- e) Me të tjerë _____.

6. **Mendoj që jam.....**

- a) Shumë i shëndetshëm,
- b) I shëndetshëm,
- c) I sëmurë,
- d) Nuk mund të vlerësoj shëndetin tim.

7. E vlerësoj fitnesin tim motorik si...

- a) Jashtëzakonshëm,
- b) Shumë i mirë,
- c) Mirë,
- d) Mjaftueshëm,
- e) I keq.

8. Prindërit e juaj, a ndërmarrin ndonjë formë të sportit në kohën e tyre të lirë?

Nëna

- a) Nuk ndërmerr,
- b) Nganjëherë ndërmerr,
- c) Rregullisht ndërmerr,
- d) Nuk e di.

Babai

- a) Nuk ndërmerr,
- b) Nganjëherë ndërmerr,
- c) Rregullisht ndërmerr,

4.4 Përpunimi statistikor i të dhënave

Për përpunimin e të dhënave do të përdoret “Chi Square Test” që na lejon të dimë nëse dy grupe kanë mendime shumë të ndryshme, gjë që e bënë atë një statistikë shumë të dobishme për hulumtimin e anketave.

5. REZULTATET E HULUMTIMIT

9. Si e kaloni kohën tuaj të lirë? (Ju mund të zgjidhni tri përgjigje)

	Urbane		Rurale		Chi-Square	Sig.
	Count	Percent	Count	Percent		
Dëgjoj muzikë	64	64.0%	74	74.0%	2.34	.13
Luaj muzikë në instrumente, këndoj në korë, në grup	5	5.0%	5	5.0%	.00	1.00
Shikoj TV. video	31	31.0%	46	46.0%	4.75	.03
Takoj shokët	21	21.0%	26	26.0%	.70	.40
Luaj letra ose lojëra bordit	3	3.0%	2	2.0%	.21	.65
Luaj lojëra të kompjuterit	12	12.0%	17	17.0%	1.01	.32
Lexoj libra, gazeta	37	37.0%	46	46.0%	1.67	.20
Praktikoj sport në klub, në një seksion të sportit	12	12.0%	2	2.0%	7.68	.01
Praktikoj sport me miqtë në fushën e sportit	35	35.0%	15	15.0%	10.67	.00
Shkoj në gara si spektator	5	5.0%	5	5.0%	.00	1.00
Shkoj në disko	1	1.0%	1	1.0%	.00	1.00
Shkoj në kinema, teatër, koncert	4	4.0%	7	7.0%	.87	.35
Hobi (p.sh.: fotografia, modelimi, mbledhja e sendeve etj.)	7	7.0%	2	2.0%	2.91	.09
Çfarë lloj hobi keni?	6	6.0%	12	12.0%	2.20	.14
Vizita në familje (gjyshen, gjyshin, axhën, hallën)	13	13.0%	10	10.0%	.44	.51
Nuk bëjë asgjë (shtrihem në shtrat, ëndërroj, flejë gjatë ditës)	8	8.0%	2	2.0%	3.79	.05
Luaj me shokë	35	35.0%	28	28.0%	1.14	.29

Tabela 1 tregon se si nxënësit e zonave rurale dhe urbane e kalojnë kohën e tyre të lirë. Ne këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë të përgjigjen në tre alternativa mbi mënyrën se si ata e kalojnë kohën e tyre të lirë.

Në bazë të rezultateve të tabelës, shihet se 64 nxënës të zonës urbane dëgjojnë muzikë, gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 74 nxënës të zonës rurale janë përgjigjur se dëgjojnë muzikë gjatë kësaj kohe, sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Në alternativën e dytë, luaj muzikë në instrumente janë përgjigjur 5 nxënës të zonës urbane dhe 5 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Sa i përket alternatives së tretë, shikoj TV. video janë përgjigjur 31 nxënës të zonës urbane dhe 46 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Ne alternativën e katërt, takoj shokët janë përgjigjur 21 nxënës të zonës urbane dhe 26 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Sa i përket alternatives së pestë, luaj letra ose lojëra bordit janë përgjigjur 3 nxënës të zonës urbane dhe 2 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet

tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Në alternativën e gjashtë, luaj lojëra të kompjuterit janë përgjigjur 12 nxënës të zonës urbane dhe 17 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Sa i përket alternatives së shtatë, lexoj libra, gazeta janë përgjigjur 37 nxënës të zonës urbane dhe 46 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Në alternativën e tetë, praktikojë sport në klub, në një seksion të sportit janë përgjigjur 12 nxënës të zonës urbane dhe 2 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Sa i përket alternatives së nëntë, praktikoj sport me miqtë në fushën e sportit janë përgjigjur 35 nxënës të zonës urbane dhe 15 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Në alternativën e dhjetë, shkoj në gara si spektator janë përgjigjur 5 nxënës të zonës urbane dhe 5 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Sa i përket alternatives së njëmbëdhjetë, shkoj në disko janë përgjigjur 1 nxënës të zonës urbane dhe 1 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Në alternativën e dymbëdhjetë, shkoj në kinema, teatër, koncert janë përgjigjur 4 nxënës të zonës urbane dhe 7 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

Në alternativën e trembëdhjetë, për hobi (p.sh fotografia, modelimi, mbledhja e sendeve) janë përgjigjur 7 nxënës të zonës urbane dhe 2 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale. Në pyetjen se çfarë hobi kanë nxënësit, në alternativën vizitë në familje janë përgjigjur 13 nxënës të zonës urbane dhe 10 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të sigifikancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm

statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale. Në të njëjtën pyetje, në alternativën nuk bëjë asgjë, janë përgjigjur 8 nxënës të zonës urbane dhe 2 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e barabartë me vlerën $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim apo jo.

Në alternativën e fundit luaj me shokë mbi pyetjen e lartcekur, janë përgjigjur 35 nxënës të zonës urbane dhe 28 nxënës të asaj rurale dhe sa i përket Chi-Square testit, rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund nuk të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonës urbane dhe asaj rurale.

10. Sa herë gjatë tre muajve të fundit, keni ndërmarrë aktivitet fizik në kohën tuaj të lirë (se paku 30 minuta)

	Urbane		Rurale		Total	
	Count	Percent	Count	Percent	Count	Percent
Asnjëherë	1	1.0%	4	4.0%	5	2.5%
Më pak se një herë në javë	1	1.0%	10	10.0%	11	5.5%
Një herë në javë	6	6.0%	17	17.0%	23	11.5%
Dy herë në javë	20	20.0%	18	18.0%	38	19.0%
Tre herë në javë	28	28.0%	18	18.0%	46	23.0%
Pesë herë në javë	15	15.0%	8	8.0%	23	11.5%
Çdo ditë	29	29.0%	25	25.0%	54	27.0%
Chi-Square = 19.130 Sig. .004						

Tabela 2 tregon se sa herë gjatë tre muajve të fundit, nxënësit e zonave urbane dhe rurale kanë ndërmarrë aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (se paku 30 minuta). Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në një alternativë, se sa herë gjatë tre muajve të fundit, kanë ndërmarrë aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (se paku 30 minuta).

Bazuar në tabelën me rezultate të kësaj përgjigje, rezultatet tregojnë se 1 nxënës nga zona urbane dhe 4 nga zona rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk kanë ndërmarr aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta). 1 nxënës nga zona urbane dhe 10 nga zona rurale janë përgjigjur se, më pak se një herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë (së paku 30 minuta). 6 nxënës të zonës urbane dhe 17 nxënës të zonës rurale janë përgjigjur se një herë në javë kryejnë aktivitet fizik gjatë kohës së tyre të lirë (së paku 30 minuta). Për dy herë në javë të ndërmarrjes së aktivitetit fizik janë përgjigjur 20 nxënës nga zona urbane dhe 18 nxënës nga ajo rurale. 28 nxënës të zonës urbane dhe 18 nxënës të zonës rurale kanë deklaruar se ndërmarrin aktivitet fizik gjatë kohës së tyre të lirë, tre herë në javë. 15 nxënës të zonës urbane janë përgjigjur se pesë herë në javë ndërmarrin aktivitet fizik gjatë kohës së tyre të lirë, ndërsa 8 nxënës të zonës rurale janë përgjigjur se ndërmarrin aktivitet fizik gjatë kohës së tyre të lirë (së paku 30 minuta) në pesë herë në javë. Në alternativën e fundit se çdo ditë ndërmarrin aktivitet fizik (së paku 30 minuta) janë përgjigjur 29 nxënës të zonës urbane dhe 25 të asaj rurale.

Sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të rreshtit të 8-sigifikancë e raportuar në rreshtin e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

11. Cilat forma të aktivitetit fizik ju i ndërmerrni gjatë kohës suaj të lire?

Format e aktivitetit motorik	Nganjëherë			Asnjëherë			Shpesh			χ^2	Sig.
	U	R	T	U	R	T	U	R	T		
a) vrapim	49	63	56.0%	2	1	1.5%	49	36	36.0%	4.07	.13
b) noti	46	46	46.0%	48	37	42.5%	6	17	17.0%	6.68	.04
c) çiklizëm	29	39	34.0%	8	23	15.5%	63	38	38.0%	14.92	.00
d) roller-skating	27	19	23.0%	57	70	63.5%	16	11	11.0%	3.65	.16
e) basketboll	46	48	47.0%	31	40	35.5%	23	12	12.0%	4.64	.10
f) volejboll	40	26	33.0%	26	13	19.5%	34	61	61.0%	14.98	.00
g) futboll	22	27	24.5%	20	22	21.0%	58	51	51.0%	1.06	.59
h) hendboll	26	19	22.5%	68	74	71.0%	6	7	7.0%	1.42	.49
i) aerobik	12	19	15.5%	82	76	79.0%	6	5	5.0%	1.90	.39
j) ngritje peshe	30	29	29.5%	64	62	63.0%	6	9	9.0%	.65	.72
k)skateboarding	33	16	24.5%	64	79	71.5%	3	5	5.0%	7.97	.02
l) patinazh	20	18	19.0%	78	79	78.5%	2	3	3.0%	.31	.86
m) skijim	35	47	41.0%	59	39	49.0%	6	14	14.0%	9.04	.01
n) snowboarding	18	23	20.5%	74	70	72.0%	8	7	7.0%	.79	.67
p) gjimnastikë	52	52	52.0%	30	33	31.5%	18	15	15.0%	.42	.81
q) Artet marciale (Aikido, karate)	22	23	22.5%	72	70	71.0%	6	7	7.0%	.13	.94
r) tjera	48	65	56.5%	21	13	17.0%	31	22	22.0%	5.97	.05

U – Urban, R – Rural, T - Total

Tabela 3 tregon se cilat forma të aktivitetit fizik i ndërmarrin nxënësit gjatë kohës së tyre të lirë. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në njërin nga alternativat e aktivitetit fizik, ku çdo alternativë ka pasur tre alternativa: nganjëherë, asnjëherë dhe shpesh, nga të cilat njëra nga to është dashur të zgjidhet. Në bazë të tabelës, për alternativën e parë, 49 nxënës të zonës urbane dhe 63 nxënës të zonës rurale bëjnë vrapim nganjëherë. 2 nxënës të zonës urbane dhe 1 nxënës i zonës rurale asnjëherë nuk bëjnë vrapim, kurse 49 nxënës të zonës urbane dhe 36 nxënës të zonës rurale kanë thënë se shpesh bëjnë vrapim, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se

ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

Për alternativën e dytë (noti), 46 nxënës të zonës urbane dhe 46 të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë not. 48 nxënës të zonës urbane dhe 37 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë not. 6 nxënës të zonës urbane dhe 17 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë not gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Për alternativën e tretë (çiklizëm), 29 nxënës të zonës urbane dhe 39 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë çiklizëm, gjatë kohës së tyre të lirë. 8 nxënës të zonës urbane dhe 23 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë çiklizëm, gjatë kohës së tyre të lirë. 63 nxënës të zonës urbane dhe 38 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë çiklizëm, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

Për alternativën e katërt (rroller-skating), 27 nxënës të zonës urbane dhe 19 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë rroller-skating, gjatë kohës së tyre të lirë. 57 nxënës të zonës urbane dhe 70 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë rroller-skating, gjatë kohës së tyre të lirë. 16 nxënës të zonës urbane dhe 11 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë rroller-skating, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Për alternativën e pestë (basketboll), 46 nxënës të zonës urbane dhe 48 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë luajnë basketboll, gjatë kohës së tyre të lirë. 31 nxënës të zonës urbane dhe 40 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk luajnë basketboll,

gjatë kohës së tyre të lirë. 23 nxënës të zonës urbane dhe 12 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh luajnë basketboll, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

Për alternativën e gjashtë (volejball), 40 nxënës të zonës urbane dhe 26 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë luajnë volejball, gjatë kohës së tyre të lirë. 26 nxënës të zonës urbane dhe 13 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk luajnë volejball, gjatë kohës së tyre të lirë. 34 nxënës të zonës urbane dhe 61 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh luajnë volejball, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Për alternativën e shtatë (futboll), 22 nxënës të zonës urbane dhe 27 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë luajnë futboll, gjatë kohës së tyre të lirë. 20 nxënës të zonës urbane dhe 22 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk luajnë futboll, gjatë kohës së tyre të lirë. 58 nxënës të zonës urbane dhe 51 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh luajnë futboll, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

Për alternativën e tetë (hendboll), 26 nxënës të zonës urbane dhe 19 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë luajnë hendboll, gjatë kohës së tyre të lirë. 68 nxënës të zonës urbane dhe 74 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk luajnë hendboll, gjatë kohës së tyre të lirë. 6 nxënës të zonës urbane dhe 7 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh luajnë hendboll, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast

mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Për alternativën e nëntë (aerobik), 12 nxënës të zonës urbane dhe 19 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë aerobik, gjatë kohës së tyre të lirë. 82 nxënës të zonës urbane dhe 76 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë aerobik, gjatë kohës së tyre të lirë. 6 nxënës të zonës urbane dhe 5 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë aerobik, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

Për alternativën e dhjetë (ngritje peshe), 30 nxënës të zonës urbane dhe 29 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë ngritje peshe, gjatë kohës së tyre të lirë. 64 nxënës të zonës urbane dhe 62 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë ngritje peshe, gjatë kohës së tyre të lirë. 6 nxënës të zonës urbane dhe 9 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë ngritje peshe, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Për alternativën e njëmbëdhjetë (skateboarding), 33 nxënës të zonës urbane dhe 16 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë skateboarding, gjatë kohës së tyre të lirë. 64 nxënës të zonës urbane dhe 79 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë skateboarding, gjatë kohës së tyre të lirë. 2 nxënës të zonës urbane dhe 3 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë skateboarding, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

Për alternativën e dymbëdhjetë (patinazh), 20 nxënës të zonës urbane dhe 18 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë patinazh, gjatë kohës së tyre të lirë. 78 nxënës të zonës urbane dhe 79 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë

patinazh, gjatë kohës së tyre të lirë. 2 nxënës të zonës urbane dhe 3 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë patinazh, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Për alternativën e trembëdhjetë (skijim), 35 nxënës të zonës urbane dhe 47 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë skijim, gjatë kohës së tyre të lirë. 59 nxënës të zonës urbane dhe 39 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë skijim, gjatë kohës së tyre të lirë. 6 nxënës të zonës urbane dhe 14 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë skijim, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

Për alternativën e katërbëdhjetë (snowboarding), 18 nxënës të zonës urbane dhe 23 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë snowboarding, gjatë kohës së tyre të lirë. 74 nxënës të zonës urbane dhe 70 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë snowboarding, gjatë kohës së tyre të lirë. 8 nxënës të zonës urbane dhe 7 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë snowboarding, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Për alternativën e pesëmbëdhjetë (gjimnastikë), 52 nxënës të zonës urbane dhe 52 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë gjimnastikë, gjatë kohës së tyre të lirë. 30 nxënës të zonës urbane dhe 33 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë gjimnastikë, gjatë kohës së tyre të lirë. 18 nxënës të zonës urbane dhe 15 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë gjimnastikë, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij

aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Për alternativën e gjashtëmbëdhjetë (arte marciale (aikido, karate)), 22 nxënës të zonës urbane dhe 23 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë arte marciale (aikido, karate), gjatë kohës së tyre të lirë. 72 nxënës të zonës urbane dhe 70 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë arte marciale (aikido, karate), gjatë kohës së tyre të lirë. 6 nxënës të zonës urbane dhe 7 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë arte marciale (aikido, karate), gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Për alternativën e fundit (tjera aktivitete fizike), 48 nxënës të zonës urbane dhe 65 nxënës të asaj rurale, kanë thënë se nganjëherë bëjnë tjera aktivitete fizike, gjatë kohës së tyre të lirë. 21 nxënës të zonës urbane dhe 13 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se asnjëherë nuk bëjnë tjera aktivitete fizike, gjatë kohës së tyre të lirë. 31 nxënës të zonës urbane dhe 22 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se shpesh bëjnë tjera aktivitete fizike, gjatë kohës së tyre të lirë, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 11-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

12. Unë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme fizike, sepse... (shënoni maksimum tre arsye)

	Urbane	Rurale	Total			
	Count	Count	Count	Percent	Chi-Square	Sig.
Për karrierës sportive	37	28	65	32.5%	1.85	.17
Të takoj njerëz të rinj	6	10	16	8.0%	1.09	.30
Më pëlqejnë garat	41	58	99	49.5%	5.78	.02
Për gjendje të mire fizike	53	45	98	49.0%	1.28	.26
Për relaksim	47	33	80	40.0%	4.08	.04
Për shëndet	59	56	115	57.5%	0.18	.67
Të duket mire/bukur	10	9	19	9.5%	0.06	.81
Për nota me të mira në EF	3	8	11	5.5%	2.41	.12
Për të takuar miq	3	10	13	6.5%	4.03	.04
Për argëtim	33	25	58	29.0%	1.55	.21

Unë mund ti përmbush ambiciet e mia sportive	7	10	17	8.5%	0.58	.45
Familja më inkurajon	1	5	6	3.0%	2.75	.10
Për përfitime financiare	0	2	2	1.0%	2.02	.16

Tabela 4 tregon se përse nxënësit marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në tre alternativa, se përse marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike.

Në bazë të rezultateve të tabelës 4, 37 nga nxënësit e zonës urbane janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për karrierës sportive, kurse 28 nga nxënësit e zonës rurale kanë thënë se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fike për të njëjtën arsye, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 6 nxënës të zonës urbane dhe 10 nxënës të asaj rurale, janë përgjigjur se ndërmarrin veprimtari të ndryshme fizike për të takuar njerëz të rinj, dhe sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 41 nxënës të zonës urbane dhe 58 të zonës rurale, janë përgjigjur se ndërmarrin veprimtari të ndryshme fizike sepse atyre ju pëlqejnë garat, dhe sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 53 nxënës të zonës urbane dhe 58 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për gjendjen e tyre të mirë fizike, dhe sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 47 nga nxënësit e zonës urbane dhe 33 nga ata të zonës rurale, janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për relaksim, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sigifikancë e

raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 59 nxënës të zonës urbane dhe 56 nxënës të zonës rurale, janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për shëndet, sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sig signifkancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 10 nga nxënësit e zonës urbane dhe 9 nga nxënësit e zonës rurale, kanë thënë se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike që të duken bukur, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sig signifkancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 3 nxënës të zonës urbane dhe 8 të zonës rurale, janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për nota më të mira në Edukatë Fizike, dhe sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sig signifkancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 3 nxënës të zonës urbane dhe 10 të zonës rurale, janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për të takuar miq, dhe sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sig signifkancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e vogël se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 33 nxënës të zonës urbane dhe 25 të asaj rurale, janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për argëtim, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sig signifkancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p - 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 7 nga nxënësit e zonës urbane dhe 10 nga ata të zonës rurale, kanë thënë se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike sepse mund ti përmbushin ambiciet e tyre fizike, dhe sa i përket Chi-Square testit

rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. 1 nxënës i zonës urbane dhe 5 nxënës të zonës rurale, kanë thënë se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike sepse inkurajohen nga familja e tyre, ku sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale. Asnjë nga nxënësit e zonës urbane nuk është përgjigjur se merr pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për përfitime financiare, kurse 2 nga nxënësit e zonës rurale, janë përgjigjur se marrin pjesë në veprimtari të ndryshme fizike për përfitime financiare, kurse sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të kolonës të 6-sigifikancë e raportuar në kolonën e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

13. Unë ndërmarr aktivitet fizik në kohën lirë me...

	Urbane	Rurale	Total	
	Count	Count	Count	Percent
Me prindër	7	6	13	6.5%
Me motra dhe vëllezër	29	29	58	29.0%
Me shokë	57	53	110	55.0%
Vetë	7	10	17	8.5%
Me të tjerë	0	2	2	1.0%
Chi-Square = 2.752 Sig. .600				

Tabela 5 tregon se me kë nxënësit ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në një alternativë, se me kë ata ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë.

Në bazë të tabelës 5, rezultatet tregojnë se 7 nga nxënësit e zonës urbane janë përgjigjur se ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e lirë me prindër, ndërsa 6 nxënës të zonës rurale kanë thënë se e bëjnë të njëjtën gjë me prindër. 29 nxënës të zonës urbane kanë thënë se

aktivitetin fizik në kohën e lirë e ndërmarrin me motra dhe vëllezër, kurse për të njëjtën gjë kanë thënë, po ashtu 29 nxënës të zonës rurale. 57 nxënës të zonës urbane dhe 53 të asaj rurale janë përgjigjur se ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e tyre të lirë me shokë. 7 nga nxënësit e zonës urbane dhe 10 nga nxënësit e zonës rurale, janë përgjigjur se ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e lirë vetëm. Kurse në përgjigjen se ndërmarrin aktivitet fizik në kohën e lirë me persona të tjerë janë përgjigjur 0 nxënës nga zona urbane dhe 2 nxënës nga zona rurale. Sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të rreshtit të 6-sigifikancë e raportuar në rreshtin e fundit, për 5% nivel të signifkancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

14. Mendoj që jam.....

	Urbane	Rurale	Total	
	Count	Count	Count	Percent
Shumë i shëndetshëm	26	31	57	28.5%
I shëndetshëm	65	58	123	61.5%
I sëmur	1	0	1	.5%
Nuk mund të vlerësoj shëndetin tim	8	11	19	9.5%
	Chi-Square = 2.311 Sig. .510			

Tabela 6 tregon se çfarë mendojnë nxënësit për shëndetin e tyre. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në një alternativë se çfarë mendojnë për shëndetin e tyre.

Në bazë të rezultateve të tabelës, nga 57 përgjigje, 26 nxënës të zonës urbane mendojnë se janë shumë të shëndetshëm, kurse 31 nxënës të zonës rurale mendojnë se janë shumë të shëndetshëm. Nga 123(61.5%) përgjigje të grupit të nxënësve të të dy zonave, 65 nga ta të zonës urbane mendojnë se janë të shëndetshëm, kurse 58 nxënës të zonës rurale kanë të njëjtin mendim. Vetëm 1(0.5%) nxënës nga zona rurale është përgjigjur se mendon që është i sëmurë. Kurse nga 19(9.5%) përgjigje të marra, 8 nga nxënësit e zonës urbane nuk kanë mundur ta vlerësojnë shëndetin e tyre, dhe 11 nxënës nga zona rurale nuk kanë mundur ta vlerësojnë shëndetin e tyre. Sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të rreshtit të 5-sigifikancë e raportuar në rreshtin e fundit, për 5% nivel të

signifikancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

15. E vlerësoj fitnesin tim motorik si...

	Urbane	Rurale	Total	
	Count	Count	Count	Percent
Jashtëzakonshëm	11	13	24	12.0%
Shumë i mirë	46	38	84	42.0%
Mirë	39	36	75	37.5%
Mjaftueshëm	4	13	17	8.5%
I keq	0	0	0	0.0%
Chi-Square = 5.813 Sig. .121				

Tabela 7 tregon se si nxënësit e vlerësojnë fitnesin e tyre motorik. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në një alternativë se si nxënësit e vlerësojnë fitnesin e tyre motorik.

Bazuar në rezultatet e tabelës, nga 24(12%) përgjigje të nxënësve të të dy zonave, 11 prej tyre nga nxënësit e zonës urbane, dhe 13 nga nxënësit e zonës rurale, janë përgjigjur se e vlerësojnë fitnesin e tyre motorik si të jashtëzakonshëm. Nga 84(42%) përgjigje të të dy grupeve, 46 nxënës të zonës urbane dhe 38 nxënës të asaj rurale, janë përgjigjur se e vlerësojnë fitnesin e tyre motorik si shumë të mirë. Nga 75(37.5%) përgjigje totale, 39 nxënës të zonës urbane dhe 36 të zonës rurale, janë përgjigjur se e vlerësojnë mirë fitnesin e tyre motorik. Nga 17(8.5%) të përgjigjeve të nxënësve të të dy zonave, 4 nga ata të zonës urbane dhe 13 të zonës rurale janë përgjigjur se e vlerësojnë fitnesin e tyre motorik si mjaftueshëm, kurse asnjë nga nxënësit e të dy zonave nuk e ka vlerësuar fitnesin e tij/saj si të keq. Sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të rreshtit të 6-sigifikancë e raportuar në rreshtin e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

16. Prindi i juaj (nëna), a ndërmerr ndonjë formë të sportit në kohën e tyre të lirë?

Nëna				
	Urbane	Rurale	Total	
	Count	Count	Count	Percent
Nuk ndërmerr	38	46	84	42.0%
Nganjëherë ndërmerr	46	34	80	40.0%
Rregullisht ndërmerr	13	6	19	9.5%
Nuk e di	3	14	17	8.5%
Chi-Square = 12.258 Sig. .007				

Tabela 8 tregon për prindërit e nxënësve (nëna), se a ndërmarrin ndonjë formë të sportit në kohën e tyre të lirë. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në një alternativë, për prindërit e tyre, se a ndërmarrin ndonjë formë të sportit në kohën e tyre të lirë.

Rezultatet në bazë të tabelës tregojnë se nga 84(42%) përgjigje të nxënësve të dy zonave, 38 nxënës nga zona urbane dhe 46 nga ajo rurale, janë deklaruar se nëna e tyre nuk ndërmerr ndonjë formë të sportit në kohën e saj të lirë. Nga 80(40%) përgjigje, 46 nxënës nga zona urbane dhe 34 nga ajo rurale, janë përgjigjur se nëna e tyre nganjëherë ndërmerr ndonjë formë të sportit në kohën e saj të lirë. Nga 19(9.5%) përgjigje të grupit të nxënësve të të dy zonave, 13 nga zona urbane dhe 6 nga ajo rurale, janë përgjigjur se nëna e tyre rregullisht ndërmerr ndonjë formë të sportit gjatë kohës së saj të lirë. Nga 17(8.5%) përgjigje të nxënësve të zonës urbane dhe rurale, 3 nga nxënësit e zonës urbane dhe 14 të zonës rurale, janë përgjigjur se nuk e dinë nëse nëna e tyre ndërmerr ndonjë formë të sportit në kohën e saj të lirë. Sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të rreshtit të 5-sigifikancë e raportuar në rreshtin e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

17. Prindi i juaj (babai), a ndërmerr ndonjë formë të sportit në kohën e tij të lirë?

Babai				
	Urbane	Rurale	Total	
	Count	Count	Count	Percent
Nuk ndërmerr	16	17	33	16.5%
Nganjëherë ndërmerr	59	56	115	57.5%
Rregullisht ndërmerr	20	20	40	20.0%
Nuk e di	5	7	12	6.0%
Chi-Square = .443 Sig. .931				

Tabela 9 tregon për prindërit e nxënësve (babai), se a ndërmarrin ndonjë formë të sportit në kohën e tyre të lirë. Në këtë pyetje, nxënësit kanë pasur të drejtë që të përgjigjen në një alternativë, për prindërit e tyre, se a ndërmarrin ndonjë formë të sportit në kohën e tyre të lirë.

Rezultatet në bazë të tabelës tregojnë se nga 33(16.5%) përgjigje të nxënësve të dy zonave, 16 nxënës nga zona urbane dhe 17 nga ajo rurale, janë deklaruar se babai i tyre nuk ndërmerr ndonjë formë të sportit në kohën e tij të lirë. Nga 115(57.5%) përgjigje, 59 nxënës nga zona urbane dhe 56 nga ajo rurale, janë përgjigjur se babai i tyre nganjëherë ndërmerr ndonjë formë të sportit në kohën e tij të lirë. Nga 40(20%) përgjigje të grupit të nxënësve të të dy zonave, 20 nga zona urbane dhe 20 nga ajo rurale, janë përgjigjur se babai i tyre rregullisht ndërmerr ndonjë formë të sportit gjatë kohës së tij të lirë. Nga 12(6%) përgjigje të nxënësve të zonës urbane dhe rurale, 5 nga nxënësit e zonës urbane dhe 7 të zonës rurale, janë përgjigjur se nuk e dinë nëse babai i tyre ndërmerr ndonjë formë të sportit në kohën e tij të lirë. Sa i përket Chi-Square testit rezultatet tregojnë se në bazë të rreshtit të 5-sigifikancë e raportuar në rreshtin e fundit, për 5% nivel të signifikancës, është më e madhe se vlera $p = 0.05$, dhe në këtë rast nuk mund të themi se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve të zonave urbane dhe rurale.

6. RËNDESIDIA E HULUMTIMIT

Për shkak të mungesës së madhe të hulumtimeve të këtij lloji në Kosovë e veçanërisht në komunën e Drenasit ne jemi nxitur që të trajtojmë një problem të tillë. Kemi pak punime, të cilat kanë trajtuar problematikën e natyrës së ngjashme. Edhe ato pak punime të cilat mund të gjenden kanë qasje shumë të pjesshme të sqarimit të kësaj problematike. Shumica e hulumtimeve deri më sot, kanë trajtuar vetëm segmente të ndara të stilit të jetesës, por asnjëra prej tyre nuk ka sqarim të përmbledhur të gjendjes faktike në teren. Ky hulumtim është i rëndësishëm për disa arsye: Do të krijojë një pasqyrë të gjendjes sa i takon stilit të jetesës të fëmijëve të kategorisë të përfshirë në hulumtim. Me anë të të dhënave të fituara do të vërtetohet se do të ketë dallim të rëndësishëm statistikor të nxënësve të zonave urbane dhe rurale në komunën e Drenasit.

1. Do të kemi të dhëna për ndryshimet të cilat ekzistojnë në mes këtyre dy grupeve të anketuara.
2. Do të kemi një qasje të re të hulumtimit sa i përket mënyrës së trajtimit të problemeve, të cilat janë hulumtuar deri me tani në Kosovë, e që kanë të bëjnë me edukimin fizik.
3. Do të shërbejë si bazë e mirë, për ti paraprirë vendosjes së standardeve në nivelin kombëtar, duke e bërë të mundshëm krahasimin e gjendjes me bashkëmoshatarët e vendeve të rajonit dhe me gjerë.

7. DISKUTIMI

Stili dhe mënyra e jetesës mund të themi se është një ndër problemet më të mëdha në shoqërinë tonë kosovare. Të rinjtë tanë, e kanë të vështirë që në kohën e tyre të lirë të merren sa më shumë me aktivitete fizike, sepse sot në tregun tonë, fëmijët mund të gjejnë pajisje elektronike atraktive nga kompani të ndryshme, të cilat krijojnë edhe një konkurrencë në mes vete për sjelljen e pajisjeve elektronike të reja, e po ashtu edhe në sigurimin e pajisjeve mbështetëse si ulëse (karrige) të përshtatshme për t'i ofruar komoditet sa më të rehatshëm fëmijëve, në mënyrë që ata të merren me këtë lloj të aktivitetit pasiv. Në këtë rast prindërit mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm tek fëmijët e tyre duke u munduar që të merren sa më tepër me aktivitete të lira sportive, që të jenë një pasqyrë e mirë për fëmijët e tyre, në mënyrën se si të kalojnë kohën e tyre të lirë, duke u marrë sa më tepër me aktivitete të lira sportive, larg pajisjeve të ndryshme elektronike të cilat ndikojnë negativisht në shëndetin e fëmijëve të tyre si pasojë e mos marrjes me aktivitete të ndryshme sportive. Sipas (Nowak-Starz G, 2008) stili i jetës është imazhi i funksionimit të individit ose grupit.

Procesi i formimit të një jetese të caktuar shkon paralel me aktivitetin arsimor, por më shumë e rëndësishme bëhet në periudhën e adoleshencës. Mënyra e jetesës së një individi mund të ndikojë në forcimin e potencialit shëndetësor të tij - saj, ose përkeqësimin pra e kundërta. Kjo është arsyeja pse ne mund të flasim për karakterin e saj pro-shëndetësor ose anti-shëndetësor. Informacionin të cilin ne e kemi mbledhur gjatë këtij hulumtimi ka bërë të mundur përcaktimin e kohës së lirë, frekuencën e aktivitetit fizik të ndërmarr, pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme dhe aktivitetin fizik të prindërve të nxënësve. Krahasimi i rezultateve të nxënësve në lidhje me deklarin e aktiviteteve fizike të marra në kohën e lirë, duhet ti konsiderojmë si optimiste për faktin që shumica e të anketuarve deklaruan se janë marrë me aktivitete fizike së paku dy herë dhe tre herë në javë.

Një përgjigje të tillë me nga dy herë stërvitje në javë kanë dhënë 38 nxënës, prej tyre 20 nxënës janë nga zonat urbane, ndërsa po ashtu 18 nxënës janë nga zona rurale të cilat u përgjigjën se stërvisin dy herë në javë. Ndërsa sa i përket përgjigjes së parë që nxënësit

nuk stervisin asnjëherë në javë kemi vetëm 5 nxënës që kanë dhënë këtë përgjigje, prej tyre 1 nxënës është nga zona urbane, ndërsa 4 janë nga zona rurale, kjo tregon së të rinjtë në përgjithësi në vendin tonë ndërmarrin aktivitete të lira fizike në kohën e tyre të lirë. Rezultatet e marra tregojnë se kryesisht fëmijët kohën e tyre të lirë e kalojnë: duke dëgjuar muzikë, duke shikuar TV, duke lexuar libra, vizita familjare, duke luajtur me shokë, duke takuar shokë, është interesant se në asnjë pyetje nuk kemi 0 përgjigjeje të dhëna, ndërsa në disa pyetje kemi vetëm nga 1 përgjigje të dhënë, shkoj në disko, në këtë pyetje kemi vetëm nga një përgjigjeje, 1 përgjigje kemi nga nxënësit në zonat urbane dhe 1 përgjigje kemi nga nxënësit nga zona rurale. Numrin më të madh të përgjigjeve e kemi se nxënësit më së tepërmi në kohën e tyre të lirë dëgjojnë muzikë, 64 përgjigjeje kemi nga nxënësit në zonat urbane dhe 74 përgjigjeje kemi nga nxënësit nga zona rurale. Ndoshta në këto përgjigjeje të dhëna mund të kenë ndikuar kushtet e jetesës, niveli jo i kënaqshëm i gjendjes financiare në familje, kultura etj.

Nga një studim i kryer nga (Pawelec & Kurzak , 2013) në mes të nxënësve të shkollave të mesme në Varshavë, tregon se nxënësit e shkollave të mesme të Varshavës, për çdo ditë si dhe në fundjavë preferojnë stilin e jetesës të ulur. Kjo mund të rezultojë nga interesi i tyre për filmat, serialet dhe lojëra të ndryshme kompjuterike. Mënyra e shpenzimit të kohës së lirë në fundjavë mund të pasqyrojë mënyrën e jetesës së familjeve moderne. Preferencat më të zakonshme të kalimit të kohës së lirë në fundjavë janë të lidhura me takimet e miqve dhe familjes. Zakonet e kohës së lirë që lidhen me aktivitetin fizik janë karakteristike vetëm për nxënësit e vitit të katërt të shkollave të mesme në Varshavë. Rezultatet e hulumtimit korrespondojnë me rezultatet e studimeve të kryera në mesin e të rinjve nga (Skawiński, Zaworska, Sikora, Horecka, & Szpringer, 2011) i cili vuri në dukje se të rinjtë shpenzojnë pjesën më të madhe të kohës së tyre të lirë para kompjuterit apo TV. Konkludime të ngjashme gjithashtu nxorën (Oblecińska & Woynarowska , 2006) në studimet e mëdha të popullsisë. Gjithashtu, sipas një studimi të kryer nga (Bajurna & Jakubek , 2008) në Poloni aktivitetet për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta janë kryesisht forma të ndryshme të aktivitetit fizik, por edhe aktivitete tematike. Në këto teste, aktiviteti motorik i të rinjve u vlerësua si i moderuar. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se format më të shpeshta të kalimit të kohës së lirë janë se nxënësit më së shumti dëgjojnë muzikë, takojnë miq, luajnë me shokë, lexojnë libra, shikojnë TV,

video, vizitojnë familjarët, si dhe luajnë lojëra të kompjuterit. Arsyeja e qartë për këtë mund të jetë mungesa e qasjes në pajisje të ndryshme për tu marrë me aktivitete të ndryshme sportive. Mund të supozohet se zhvillimi i mëtejshëm ekonomik do të rezultojë në një rritje të përqindjes së të rinjve që zgjedhin forma të ndryshme të kalimit të kohës së lirë. Ndër format e veprimtarive që nuk janë zgjedhur në shifra të larta nga nxënësit janë: rolling-skating (patina), hendbolli, skateboarding, patinazhi dhe skating, artet marciale, aerobik, disa nga këto forma mund të klasifikohen si "të shtrenjta" dhe nuk janë në dispozicion të klubeve dhe sallave sportive etj. Nga ana tjetër, një numër më i madh i përgjigjeve të të anketuarve, krahasuar me aktivitetet tjera ishte se (37) nxënës nga zona urbane dhe (46) nxënës nga zona rurale në kohën e tyre të lirë lexojnë libra, (21) nxënës nga zona urbane dhe (26) nxënës nga zona rurale takojnë shokët, (35) nxënës të anketuar nga zona urbane dhe (28) nxënës nga zona rurale treguan se kohën e tyre të lirë e shpenzojnë duke luajtur me shokë, (31) nxënës nga zona urbane dhe (46) nxënës nga zona rurale shikojnë TV apo video të ndryshme, ndërsa (64) nxënës e të anketuarve nga zona urbane dhe (74) nxënës nga zona rurale treguan se kohën e tyre të lirë e kalojnë duke dëgjuar muzikë. Është interesante për dallim nga moshataret e tyre në disa vende në bashkimin Evropian se (13) nxënës nga zona urbane dhe (10) nxënës nga zona rurale në kohën e tyre të lirë bëjnë vizita familjare, krahasuar me fëmijët nga disa vende të bashkimit Evropian që kanë një përqindje shumë më të ulët të vizitave familjare (Glapa, Bronikoëski, Górka, & Morina, 2013). Efikasiteti i edukimit shëndetësor (dhe jo vetëm) kërkon pajtueshmëri mes arsimit shëndetësor të realizuar në shkolla dhe përvoja e nxënësit në familje. Një ndikim i rëndësishëm në zhvillimin e mënyrës së jetesës dhe sjelljes shëndetësore ka edhe familja. Është treguar se kjo mbështetje është e dobishme për sa i përket krijimit të shprehive të mira shëndetësore. (Wojciechowska, Mojs , & Stanisławska , 2008). Në hulumtim, nxënësit u pyetën për prindërit nëse marrin ndonjë aktivitet (veçmas nënat dhe baballarët). Në rastin e nënave, përgjigjet u ndanë në mes nuk ndërmarrin dhe nganjëherë ndërmarrin, vlen të tregohet se (84) nxënës e të anketuarve u përgjigjën se nënat e tyre nuk ndërmarrin asnjëherë ndonjë formë të aktivitetit fizikë, ku nga ta (38) e të anketuarve ishin nga zona urbane, ndërsa (46) e të anketuarve ishin nga zona rurale, (80) nxënës u përgjigjën se nganjëherë nënat e tyre ndërmarrin aktivitete fizike, ku nga ta (46) ishin nga zona urbane, ndërsa (34) ishin nga zona rurale. Nga ana tjetër, në rastin e baballarëve aktiviteti fizik u vlerësua më mirë. Të anketuarit në një

numër më të madh (40) nxënës u përgjigjën se baballarët rregullisht ndërmarrin aktivitet fizik, ku nga ta (20) e të anketuarve ishin nga zona urbane, ndërsa (20) e të anketuarve ishin nga zona rurale. Ndërsa (115) nxënës u përgjigjën se babai i tyre nganjëherë ndërmarrin aktivitete fizike, ku nga ta (59) e të anketuarve ishin nga zona urbane, ndërsa (56) e të anketuarve ishin nga zona rurale.

Kjo situatë mund të shkaktohet nga ndarja e ndryshme e detyrave familjare dhe në përgjithësi perceptimi i ndryshëm i rolit tradicional të një burri, kreu i familjes në vendin tonë, kushteve të ndryshme socio - kulturore dhe fetare etj. Nevoja për veprim për shëndetin e të rinjve vihet re në dokumentet e rëndësishme ndërkombëtare në të cilat përsëriten shumë rekomandime të përbashkëta mbi nevojën për përmirësimin e sistemit të kujdesit shëndetësor, promovimin e mënyrave të jetesës së shëndetshme, përmirësimin e aftësive jetësore si një strategji moderne për parandalimin e shumë çrregullimeve. Një ide e rëndësishme është që t'u mundësohet të rinjve të japin përparësi dhe të krijojnë programe për të mirën e shëndetit të tyre (West & Sweeting, 2004). Duket se në vendin tonë kjo është e vështirë të arrihet në fazën e tanishme të zhvillimit të sistemeve të arsimit dhe shpesh traditave arsimore shumë autoritare. Shpresojmë se suksesi do të rritet duke futur në kurrikulën bërthamë nevojën për të përcaktuar disa zgjidhje dhe plane arsimore së bashku me nxënësit. Krijimi i pabarazisë sociale mund të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të shëndetit të publikut dhe të grup moshave të përzgjedhura. Marrëdhënia midis faktorëve socialë dhe shëndetit të adoleshentëve është komplekse. Marrja e konkluzioneve mbi dallimet varet nga faktorët e pranuar shëndetësorë dhe socialë. Besohet se gjatë periudhës së adoleshencës dallimet shëndetësore nuk tregojnë aq fort sa në fëmijërinë e hershme dhe gjatë moshës madhore (Sińczuch, 2009). Arsyeja për këtë është ndikimi më i vogël i faktorëve që lidhen me jetën familjare dhe më të mëdha se ato që lidhen me një grup të përbashkët. Ky hulumtimi tregon se niveli i pasurisë (jo shumë i mirë i familjes, por edhe në të gjithë vendit) mund të ketë ndikim në zgjedhjen e aktiviteteve të ndërmarra nga të rinjtë. Pa dyshim, faktorët socio - kulturorë dhe tradita e jetës shoqërore gjithashtu kanë ndikim të madh dhe ndikojnë në mënyrën e shpenzimit të kohës së lirë (siç mund të shihet veçanërisht në rastin e të testuarve në vendin tonë).

8. PËRFUNDIMI

Përpjekjet në identifikimin e mënyrës së shpenzimit të kohës së lirë nga ana e nxënësve në vendin tonë është shumë e rëndësishme dhe ndikon pozitivisht si një pasqyrë se çfarë duhet të ndërmarrim ne si shoqëri në të ardhmen në gjetjen e rrugëve dhe mënyrave me të përshtatshme në stimulimin e të rinjve, që të merren sa më tepër me aktivitete të lira fizike në mënyrë që të jenë sa më të shëndetshëm.

Hulumtimi u realizua me qëllim të përcaktimit të gjendjes aktuale “stili i jetesës” të fëmijëve tanë se sa merren me aktivitete të ndryshme sportive në kohën e tyre të lirë si dhe nëse ka një ndryshim statistikisht të rëndësishëm në mes të nxënësve nga zonat urbane dhe rurale në komunën e Drenasit. Mostra përbëhej nga 200 nxënës nga shkolla të ndryshme në Komunën e Drenasit (12 - 15) vjeçar. Mostra totale përfshiu 200 nxënës të anketuar, 100 nga zonat urbane dhe 100 nga zonat rurale.

Të dhënat janë mbledhur përmes një ankete (pyetëtori), një mjet hulumtues i përdorur për të vlerësuar mënyrën e jetesës së nxënësve, pyetësor i quajtur "Stili i jetës time", i hartuar nga një ekip hulumtuesish evropianë [Telama R., Naul R., Nupponen H., Rychtecky A., Vuolle P., 2002]. Pyetëtori është përkthyer dhe përshtatur nga një ekip profesional përkthyesish në bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, Prishtinë. Hulumtimi është zhvilluar në grupin e 200 nxënësve të moshës 12-15 vjeçare, nga të cilët 100 nxënës kanë qenë nga zona urbane, ndërsa 100 nxënës nga zonat rurale.

Në përputhje me objektivat e hulumtimit dhe hipotezave janë marrë edhe rezultatet që tregojnë se në disa raste janë vërtetuar hipotezat e parashtruara, ndërsa në disa raste ato janë refuzuar.

Sa i përket pyetjes së parë se si nxënësit e kalojnë kohën e tyre të lirë dhe vërtetimit ose refuzimit të hipotezave të parashtruara, më poshtë do ti përshkruajmë të dhënat e marra. Dëgjoj muzikë, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra,

konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Luaj muzikë në instrumente, këndoj në korë, në grupe gjatë kohës së lirë, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Shikoj televizionin, e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Takoj shokët e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Luaj me letra gjatë kohës së lirë, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Luaj lojëra të kompjuterit, e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Lexoj libra, gazeta, e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Praktikoj sport në klube, në një seksion të sportit, e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Praktikoj sport me miqtë në fushën e sportit, e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Shkoj në gara si spektator, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Shkoj në disko, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Shkoj në kinema, teatër, koncert, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se

nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Kanë hobi (p.sh.: fotografia, modelimi etj.), e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Bëjë vizita në familje (gjyshen, gjyshin, axhën, hallën), e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Nuk bëjë asgjë (shtrihem në shtrat, ëndërroj, flejë gjatë ditës)nuk mund të konkludojmë se ka apo nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Luaj me shokë, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Në pyetjen “Sa herë gjatë tre muajve të fundit, keni ndërmarrë aktivitet fizik në kohën tuaj të lirë (se paku 30 minuta)?” dhe vërtetimit ose refuzimit të hipotezave të parashtruara, më poshtë do ti përshkruajmë të dhënat e marra nga kjo pyetje: Në këtë rast e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Sa i takon pyetjes: “Unë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme fizike, sepse:?” dhe vërtetimit ose refuzimit të hipotezave të parashtruara, më poshtë do ti përshkruajmë të dhënat e marra. Për karrierë sportive, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Të takojnë njerëz të rinjë, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Ju pëlqejnë garat, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Për gjendje më të mire

fizike, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Për relaksim, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Për shëndet, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Të duken bukur, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Për nota më të mira në lëndën e Edukatës Fizike në shkollë, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Për të takuar miq të rinjë, e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Për argëtim, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Për të përmbushur ambicie më të mira, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Familja i inkurajon, e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale. Për përfitime financiare, e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Sa i përket pyetjes: “Unë ndërmarr aktivitet fizik në kohën e lirë me:?” dhe aspektit të vërtetimit ose refuzimit të hipotezave të parashtruara, më poshtë do ti përshkruajmë të dhënat e marra. Në këtë rast e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Sa i përket pyetjes: “Mendoj që jam: ?” dhe vërtetimit ose refuzimit të hipotezave të parashtruara, më poshtë do ti përshkruajmë të dhënat e marra. Në këtë rast e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Sa i përket pyetjes: “E vlerësoj fitnesin tim motorik si: ” dhe vërtetimit ose refuzimit të hipotezave të parashtruara, më poshtë do ti përshkruajmë të dhënat e marra. Në këtë rast e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Sa i përket pyetjes: “Prindërit e juaj, a ndërmarrin ndonjë formë të sportit në kohën e tyre të lirë?” –(Nëna) dhe vërtetimit ose refuzimit të hipotezave të parashtruara, më poshtë do ti përshkruajmë të dhënat e marra. Në këtë rast e pranojmë hipotezën zero dhe e refuzojmë alternativën. Pra, konkludojmë se nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Sa i përket pyetjes: “Prindërit e juaj, a ndërmarrin ndonjë formë të sportit në kohën e tyre të lirë?” –(Babai) dhe vërtetimit ose refuzimit të hipotezave të parashtruara, më poshtë do ti përshkruajmë të dhënat e marra. Në këtë rast e refuzojmë hipotezën zero dhe e pranojmë alternativën. Pra, konkludojmë se ka dallim të rëndësishëm statistikor të këtij aktiviteti në mes të nxënësve nga zona urbane dhe rurale.

Tejkalimi i pabarazisë sociale mund të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të shëndetit të nxënësve të grup moshave të përzgjedhura. Marrëdhënia midis faktorëve social dhe shëndetit të adoleshentëve është komplekse. Besohet se gjatë periudhës së adoleshencës dallimet shëndetësore nuk tregojnë aq fort sa në fëmijërinë e hershme dhe gjatë moshës madhore (Sińczuch, 2009). Arsyeja për këtë është ndikimi më i vogël i faktorëve që lidhen me jetën familjare dhe më të mëdha se ato që lidhen me një grup të përbashkët. Hulumtimi tregon se niveli i të ardhurave mujore familjare, mund të ketë ndikim në zgjedhjen e aktiviteteve të ndërmarrja nga të rinjtë. Pa dyshim, faktorët socio-kulturorë dhe tradita e jetës shoqërore gjithashtu kanë ndikim të madh dhe vendosin

mënyra të caktuara të shpenzimit të kohës së lirë. Vëzhgimet e mësipërme, duke marrë parasysh kushtet lokale, në të ardhmen duhet të jenë një pikënisje për ata që planifikojnë ndryshimet në sistemet e edukimit fizik në vendin tonë.

Conclusion

The attempt to identify student's leisure time in our country is very important and it effects positively as a mirror on what to undertake as a society in the future in finding more suitable ways stimulating young people to undertake as many free physical activities so they become healthier.

The research has been conducted aiming to identify the actual children's 'life style' on how much they do different sports activities in their leisure time and if there is any statistical important change between students in rural and urban areas of Drenas municipality. The sample contains 200 students from different schools (aged 12-15). The sample included 200 surveyed, 100 in rural and 100 in urban areas.

The data has been collected through a survey (questionnaire), a researcher tool used to evaluate student's lives, called "My life's style", designed by a European research team (Telama R, Naul R., Nupponen H., Rychtecky A., Vouille P., 2002). The questionnaire has been translated into Albanian by a professional translator's team in cooperation with the Faculty of Physical Education and Sports, Pristina.

In accordance with the surveys objectives and hypothesis we've seen results which show that in some cases the hypothesis has been proven real and, in some cases, they have been refused.

Regarding the question on how students spend their free time and confirmation or hypothesis refusal, below we will describe the received data. Listening to music-we accept zero hypothesis and we refuse the alternative. We come to conclusion that there is no important statistical difference for this activity between students in rural and urban areas. Play musical instruments, chorus singing, singing in group in leisure time-we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we come to conclusion that there is no important statistical difference of these activities in rural and urban areas. Watch television-we refuse zero hypothesis and we accept the alternative. We come to conclusion that there is an important statistical difference of this activity amongst students in rural and urban areas. Meet friends- we refuse zero hypothesis and we accept the alternative. There are some important statistical differences of this activity amongst

students in rural and urban areas. Play cards in my free time-we accept zero hypothesis and we refuse the alternative. We conclude that there is no important statistical difference of this activity amongst students in rural and urban areas. Play computer games, we refuse zero hypothesis and accept the alternative. Read books, newspapers- we refuse zero hypothesis and we accept the alternative. We conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Practice sports in clubs, in a sports session-we refuse zero hypothesis and we accept the alternative. We conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Practice sports with friends in sports fields, we refuse zero hypothesis and we accept the alternative. We conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Go to competitions as a spectator, we accept zero hypothesis and accept the alternative. We conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Go to discos- we accept zero hypothesis and refuse the alternative. We conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Go to the cinema, theatre, concerts- we accept zero hypothesis and refuse the alternative. We conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

They have hobbies (for example: photography, modeling etc.)- we accept zero hypothesis and we refuse the alternative. We conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

Visiting family and relatives- we accept zero hypothesis and refuse the alternative. We conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

Do nothing (lay in bed, dream, sleep during the day)- we cannot conclude if there is or if there is not any important statistical difference of this activity amongst students in rural and urban areas.

Play with friends-we accept zero hypothesis and refuse the alternative. We conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

In the question “How often during the last three months have you undertaken any physical activity during your leisure time (at least 30 minutes)?” and hypothesis confirmation and refusal submitted, we will describe received data from these questions: In this case we refuse zero hypothesis and accept the alternative. We come to conclusion that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

Regarding the question: “I participate in different physical activities and why?” and hypothesis confirmation or refusal submitted, we will describe received data below. For sportive career, we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there is no important statistical difference of this activity amongst students in rural and urban areas. Meeting new people, we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Do you like competitions-we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. For good physical condition, we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Relaxing, we accept zero hypothesis and refuse the alternative. We conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. For better health, we accept zero hypothesis and refuse the alternative. We conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Looking good-we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

For better grades in PE (Physical Education) at school, we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Meeting new friends, we refuse zero hypothesis and accept the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

For entertainment, we accept zero hypothesis and refuse the alternative. We conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. To fulfill better ambitions, we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas. Family encourages them, we refuse zero hypothesis and accept the alternative. We come to the conclusion that there are important statistical differences of this activity amongst students in urban and rural areas. For financial gains, we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

Regarding the question “In my free time I take physical activities with...?” and the aspect of confirmation or refusal of given hypothesis, below we will describe the received data. In this case we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

Regarding the question “I think I am...?” and confirmation or refusal of presented hypothesis, below we will describe the received data. In this case we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

Regarding the question “I appreciate my motoric fitness as...?” and confirmation or refusal of the given hypothesis, below we will describe received data. In this case we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

Regarding the question “Do your parents practice any sports in their free time?” (Mother) and confirmation and refusal of given hypothesis, below we will describe the received data. In this case we accept zero hypothesis and refuse the alternative. So, we conclude that there are no important statistical differences of this activity amongst students in rural and urban areas.

Regarding the question “Do your parents practice any sports in their free time? (Father), and confirmation or refusal of the given hypothesis, below we will describe the received data. In this case we refuse zero hypothesis and accept the alternative. So, we conclude that there are important statistical differences amongst students in rural and urban areas. Overcoming social inequality can contribute in overall improvement of chosen student groups. The relation between social factor and teenage health is complex. It is believed that during teenage years health differences are not shown that much as they show in early childhood and during adulthood (Sińczuch, 2009). The reason for this is the small impact which are connected with family life and bigger than those which are connected with a common group. The research shows that the level of family’s monthly income may affect in choosing which activities the young people choose. There is no doubt that socio-cultural factors and the traditional lifestyle of the society have as well a big impact and decide on the ways how to spend free time. The above monitoring, taking in consideration local conditions, in the future will be a starting point for those who plan changes in physical education system in our country.

9. LITERATURA

- Andrijašević, M. (2000). *Rekreacijom do zdravlja i ljepote*. Zagreb: Fakultet za fizičku kulturu.
- Andrijašević, M. (2000). Slobodno vrijeme i igra. In M. Andrijašević, *Zbornik radova 9*. (fv. Zagrebački sajam sporta i nautike 7-15). Zagreb: Zagreb: Zagrebački športski savez, Zagrebački.
- Andrijašević, M. (2000). *Slobodno vrijeme i igra*. In M. Andrijašević (Ed.), *Zbornik radova 9*. Zagreb: Zagrebački športski savez, Zagrebački.
- Badrić, M., Prskalo, I., & Kvesić, M. (2011). Važnost kineziološke aktivnosti u formiranju slobodnog vremena djece In V. Findak (Ed.), *Zbornik radova 20 ljetna škola kineziologa. Hrvatski kineziološki savez*, 400 - 405.
- Badrić, M; Prskalo, I; Šilić, N;. (2011). Razlike u strukturi slobodnog vremena između. *Zbornik radova 6.*, (fv. 58–64). Poreč: Hrvatski kineziološki savez.
- Bajurna, B., & Jakubek, E. (2008). *Zachowania zdrowotne młodzieży w aspekcie umiejętności spędzania wolnego czasu W: Szanse i bariery w ochronie zdrowia*. Poznań: Wybrane aspekty organizacyjne, prawne, psychologiczne [red.] Głowacka, E. Mojs.
- Basić, L. e. (1993). *Integralna metoda*. Zagreb: Alinea: priručnik za odgajatelje i stručne suradnike predškolskih.
- Dąbrowski, Z. (1966). *Czas wolny dzieci i młodzieży*. Warszawa: Państwowe Zakłady Wydawnictw Szkolnych, PZWS.
- Dumazedier J. (1956). *Rzeczywistość czasu wolnego a ideologia*. *Nowoczesna Kultura*, 36:56.
- Glapa, A., Bronikowski, M., Górka, J., & Morina, B. (2013). LEISURE TIME ACTIVITIES AMONG YOUNG PEOPLE AGED 13-16 FROM KOSOVO, BULGARIA AND POLAND. *Journal of Physical Education & Health*, 33-42.
- Nowak-Starz G. (2008). *Rozwój i zagrożenia zdrowia populacji w wieku rozwojowym w okresie przemian społeczno-ekonomicznych w Polsce*. Kielce: Wszechnica Świętokrzyska.

- Oblecińska, A., & Woynarowska, B. (2006). *Zdrowie subiektywne, zadowolenie z życia i zachowania zdrowotne uczniów szkół ponadgimnazjalnych w Polsce*. Warszawa, Wydawnictwo Ezdorant: Instytut Matki i Dziecka.
- Pawelec, K., & Kurzak, M. (2013). *Zachowania zdrowotne warszawskich gimnazjalistów*. Zeszyty Naukowe WSKFiT.
- Sińczuch, M. (2009). Polityka młodzieżowa jako odrębny obszar działania Unii Europejskiej W: Polityka młodzieżowa. [red.] Zielińska G. 147 – 172.
- Skawiński, D., Zaworska, W. A., Sikora, D., Horecka, L. A., & Szpringer, M. (2011). *Ocena poziomu wiedzy z zakresu profilaktyki wad postawy wśród dzieci i młodzieży*. Studia Medyczne.
- Telama, R; Naul, Roland; Nupponen, H; Rychtecky, A; Vuolle, P;. (2002). *Physical Fitness, Sporting Lifestyles and Olympic Ideals: Cross-Cultural Studies on Youth Sport in Europe. vol. 11 of Sport Science Studies*. UNIVERSITÄT DUISBURG-ESSEN: Hofmann.
- The child's leisure time*. (a.d.). This site contains information about the Swedish society and is run by the County Administrative Boards of Sweden: information om sverige.
- Umiastowska, D. (1999). *Styl życia, wiedza o olimpizmie i sprawność fizyczna szczecińskich uczniów*. Wydawnictwo Naukowe Uniwersytetu Szczecińskiego.
- West, P., & Sweeting, H. (2004). Evidence on equalization in health in youth from the West of Scotland. 59:13-27.
- Wojciechowska, J., Mojs, E., & Stanisławska, K. (2008). *Regulacyjne właściwości programów prewencji otyłości u dzieci i młodzieży a środowiskowe czynniki ryzyka* (Vwll. i 4). Pielęgniarstwo Polski.